

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE "S P A T A" shpk



Une **ELMAZ SPATA**, i biri i Gjetanit dhe i Humes, i datlindjes 1 Maj 1957, vendosa te themeloje shoqerine tregetare private me pergjegjesi te kufizuar per te ushtruar veprimtari ndertuese

Neni 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar emertohet "S P A T A" Shpk Tirane.

Neni 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise do te jete ne fshatin Bllicë.

Neni 3

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria me pergjesi te Kufizuar "S P A T A" Shpk, do te zhvilloje veprimtari ndertuese, per nje periudhe jo me pak se 10 vjet me te drejte zgjatje te afatit te veprimtarise.

Neni 4

Sipas legjislacionit shqipetar, Shoqeria Tregetare "S P A T A" shpk eshte person juridik dhe aktivitetin e saj e rregullon ne baze te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992, nga normat e parashikuara ne e statutin qe i bashkangjitet ketij akt themelimi. Shoqeria pergjigjet ne maredhenjet me te trete vetem me fondet e veta dhe ortaku pergjigjet vetem per detyrimet e kesaj shoqerie.

Neni 5

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se Shoqerise Tregetare "S P A T A" Shpk do te jete ushtrimi i veprimtarise se lire private ne fushen e ndertimit si:

PER ZBATIM : Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, ndertime civile dhe ekonomike, ndertim ujesjellsash e kanalizime, ndertime vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese, punime mbrojtjeje dhe sistemimi hidraulike.

Rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj.

Mirembajtja, zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane.

Gjithashtu ushtrimin e aktivitetit privat ne fushen e tregtimit me pakice dhe shumice te artikujve ushqimore, industriale, import eksportin e tyre, etj.

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 100000 (Njeqind mije)leke, i cili eshte likujduar prane Bankes perkatese.

Neni 7

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria "S P A T A " Shpk do te administrohet e do te drejtohet krahas gjithë veprimtarise e ecurise se saj do te organizohet e permiresohet nga ortaku i saj i vetem Elmaz Spata.

Neni 8

VEPRIMTARIA EKONOMIKE

Veprimtaria ekonomike e shoqerise realizohet dhe garantohet ne baze te legjislacionit ne fuqi Republiken e Shqiperise dhe sipas dokumentave te themelimit te shoqerise.

Krahas persosjes se metejshme te legjislacionit ne pergjithesi dhe atij tregetar ne veçanti ne Republiken e Shqiperise, ortaku i saj ka te drejten e permiresimit te metejshem dhe te dispozitave te ketij akti themelimi.

Neni 9

LIKUJDIMI I SHOQERISE

Rastet e likujdimit te shoqerise do te jene ato qe parashikohen ne dispozitat ligjore qe jane ne fuqi ne legjislacionin shqiptar.

Ky akt themelimi ka si pjese perberese te tij edhe statutin e shoqerise i cili i bashkangjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.


Ne rastet e likujdimit perfundimtar te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi pushojne se vepruari Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqerise.

Çdo ndryshim qe mund ti behet ketij akti dhe statuti te shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe pervojen si dhe me ecurine e shoqerise do te pasqyrohet me shkrim dhe do te neneshkruhet nga ortaku i saj dhe do te zbatohet ne Zyren e Rregjistrimit Tregetar ne gjykatën e Rrethit Tirane dhe ne Zyren e Tatimeve.

Ky akt themelimi u perpliu ne pese kopje dhe u neneshkruar nga ortaku rregullisht.

ORTAKU

Elmaz Spata





STATUTI
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“S P A T A “ Shpk

Sot me daten 31.07.1998 (nentedhjetë e tetë) unë ortaku Elmaz Spata, i biri i Gjetanit dhe i Humes, i datlindjes 1 Maj 1957, lindur e banues në Bllaçë të Peshkopisë, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, me pasaportë nr. 0188548, vendosa që të krijoj shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “S P A T A “ Shpk, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit 7638 datë 19.11.1992 për shoqëritë tregëtare sipas kushteve që vijon:

Neni 1

Shoqëri Tregëtare “S P A T A ” shpk e krijoj sipas llojit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 2

EMERTIMI DHE SELIA

Emertimi i Shoqërisë është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “S P A T A “shpk.
Selia e saj është në Bllaçë të Peshkopisë.

Neni 3

KOHEZGJATJA

Shoqëria “S P A T A ” Shpk do të funksionojë për një periudhë kohe mbi 10 vjet, duke patur të drejtën që ta zgjasë veprimtarinë e saj dhe për të ardhmen.

Neni 4

OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqëria “S P A T A ” shpk ka për objekt ushtrimin e veprimtarisë së lire private në fushën ndërtimore si:

PER ZBATIM : Punime dheu, sitemime, taracime terrenesh, ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtim ujësjellsash e kanalizime, ndërtime vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese, punime mbrojtjeje dhe sistemimi hidraulik.

Rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, etj.

Mirembajtja ,zhvillimi i dekorit në mjedise urbane.

Gjithashtu ushtrimin e aktivitetit në fushën e tregëtimit me pakicë dhe shumicë të artikujve ushqimorë, industriale, import ,eksportin e tyre ,etj.

Neni 5

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali baze fillestar i shoqërisë “S P A T A ” Shpk, është 100000 (njëqind mijë) leke dhe është likuiduar plotësisht pranë bankës perkatese.

Neni 6

REGJIMI JURIDIK

Shoqëria “S P A T A “ Shpk, veprimtarinë e saj e ushtron në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, që pasqyrohet sidomos në ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 për shoqëritë tregëtare.





Per cdo ceshjte qe nuk trajtohet ne dispozitat e ligjit te mesiperm, shoqeria zbaton praktikat e vecanta, te cilat marrin perparesi ndaj praktikave te pergjitheshme. Ne mungese te tyre zbatohen dispozitat e Kodit civil te Republikes se Shqiperise.

Shoqeria gezon personalitet juridik qysh nga dita e rregjistrimit te saj ne regjistrin Tregetar ne gjykatën e rrethit Tirane, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ajo mund te marre persiper detyrime dhe te padise dhe te paditet perpara organeve kopetente gjyqesore si ne Gjykatën e Rrethit te Peshkopise, ashtu edhe ne Gjykatën e vendeve te tjera ku do te ushtroje veprimtari private.

Shoqeria do te kete vulen e saj me mbishkrimin "SHOQERIA" S P A T A " , SHPK Peshkopi , Albania.

STRUKTURA ADMINISTRATIVE E SHOQERISE

Neni 7

.Shoqeria do te administrohet dhe do te drejtohet nga ortakut i vetem i saj ELMAZ SPATA, qe do te jete edhe administratori i saj .Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise do te organizohet dhe do te permiresohet struktura administrative e saj ,ashtu sicdo da shohe te arsyeshme ortakut i saj.

Kompetencat kryesore te ortakut te saj jane:

- Te beje ndryshime ne dispozitat e statutit te shoqerise dhe te kapitalit baze te saj.
- Te beje ndryshime ne objektin e veprimtarise se shoqerise.
- Te miratoje rezultatet vjetore.
- Te organizoje, te shperndaje dhe te mbylle shoqerine.
- Te vendose per çmimet e punimeve qe do te beje shoqeria.
- Te emeroje personelin, te vendose shperblimin e tyre, te marre punonjës me kontrate

pune etj.

Neni 8

DISPOZITAT EKONOMIKE

Veprimtaria ekonomike e shoqerise realizohet dhe garantohet ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Per detyrimet e veta ne qarkullimin tregetar dhe juridik me persona te trete, shoqeria pergjigjet me pasurine e vet.

Aktiviteti dhe pasiviteti I shoqerise pasqyrohet ne planet ekonomike financiare te saj te shprehura ne para ose valute te huaj.

Pasuria e shoqerise vleresohet nepermjet bilanceve ekonomike financiare te saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.


Te ardhurat e shoqerise pasi zbriten shpenzimet e amortizimit te pasurise se luajteshme e te paluajteshme, si dhe shpenzimet e tjera, qe behen ne interes te shoqerise edhe pershlyerjen e tyre me te ndryshme I kalon ortakut themelues te shoqerise.

Neni 9

LLOGARIA E SHOQERISE

Shoqeria e ka llogarine e saj ne Banke si dhe mund te cele llogari rrjedhese dhe ne cdo banke tjeter.

Te gjitha shpenzimet e shoqerise ne leke dhe ne valute te huaj sigurohen nga arketimet e sherbimeve dhe te tregetimeve te ndryshme qe ben ne baze te objektit te veprimtarise se saj, si dhe nga menyra te tjera qe lejon legjislacioni ne fuqi.



Neni 10

VITI EKONOMIK

Viti ekonomik qe fillon ne Janar dhe perfundon ne Dhjetor te cdo viti kalendarik, kurse ai per vitin 1998 fillon qysh nga dita e fillimit te veprimtarise dhe perfundon me mbi 10 vjet.

Neni 11

DHENJA E LLOGARISE EKONOMIKE

Shoqeria funksionon ne baze te dispozitave ligjore ekonomike ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, te dispozitave te aktit te themelimit dhe te statutit te krijimit te saj ,si dhe programeve te vecanta qe do te hartoje vete ortaku per cdo vit ekonomik.

Llogaria ekonomike e shoqerise mbeshtetet ne llogarite e tregetimit te llojeve te sherbimeve dhe te veprimtarise se saj si dhe te financimeve qe mbulon shpenzimet nga arketimet e veta, duke perfshire edhe ato ne valute. Per nxitjen ekonomike te veprimtarise se shoqerise do te krijohen fonde rezerve dhe fonde te tjera te vecanta ne perputhje me mundesite qe krijohen. Mbajtja e kontabilitetit te shoqerise do te behen sipas rregullave, metodave dhe teknikave kontabile, veprimeve qe kryhen ajo si dhe te ngjarjeve qe i ndodhin gjate ushtrimit te veprimtarise se saj ekonomike, financiare dhe tregetare. Kontabiliteti mbahet ne gjuhen shqipe dhe ne leke shqiptare.

Neqoftese do ta shohe te arsyeshme ortaku i shoqerise, do te perdore, pervec librave te detyrueshem edhe libra te tjera per rregjistrimin e ngjarjeve dhe gjendjeve qe paraqiten dhe nevojiten.

Forma e organizimit te kontabilitetit do te zgjidhet nga vete ortaku duke patur parasysh qe ajo te siguroje:

- rregjistrimin e hollesishem dhe kronologjik te te gjitha veprimeve dhe te ngjarjeve qe trajtohen ne kontabilitet.
- ruajtjen e te dhenave dhe disponimin e tyre ne cdo kohe.
- pregatitjen e dokumentave permbledhese te parashikuara ose te kerkuara.
- kontrollin e saktetise se te dhenave te trajtuara.

Cdo forme organizimi te kontabilitetit qe do te perdore, do te jete e tille qe te mundesoje kryerjen e kontrollit te jashtem ne menyre te tille, qe cdo ekspert te nxjerre nga linrat kontabel brenda nje kohe te arsyeshme, nje pamje te pergjitheshme te veprimeve te kryera dhe te gjendjes se shoqerise.

Neni 12

Raporti vjetor i llogarise se shoqerise do te paraqitet ne formen dhe permbajtjen e caktuar ne nenin 211 te ligjit 7638 date 19.11.1992 per shoqerite tregetare

Kontrolli i perditeshem kontabel dhe statistikor behet mbi bazen e dispozitave ligjore qe veprojne ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 13

KREDITE E SHOQERISE

Shoqeria ka te drejte te marre kredi ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, te rregullave te percaktuar nga Banka dhe te procedurave te percaktuara ne kete statut.

Neni 14

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Personeli i Administrates dhe punonjesit e tjere te caktohen (emerohen), sigurohen dhe shperblehen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.



Mosmarveshjet qe mund te lindin midis paleve te ndryshme ne procesin e punes dhe te veprimtarise se perditeshme, neqoftese nuk do te arrihet te zgjidhen me mirekuptim e bisedime reciproke, per te cilen duhen bere perpjekje, do te zgjidhen nga gjykata e tiranes ose e gjykatave te tjera ku do te ndodhin.

Te gjitha dokumentat e shoqerise (kontrata, akt marveshje, fatura, etj, do te permbajne adresen e plote te saj, numurin e rregjistrimit ne gjykate si dhe ate te organit tatimor. Per ceshtje te tilla qe nuk parashikohen ne kete statut, veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne legjislacionin perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

DISPOZITA TE FUNDIT

Hyrja ne fuqi

Ky statut I perpiluar ne pese kopje te njejta nga ortaku themelues te shoqerise hyn ne fuqi qysh nga momenti I neneshkrimit te tij ne organin perkates te Noterise Tirane. Krahas persosjes se metejshme te legjislacionit ne pergjithesi dhe atij tregetar ne vecanti ne Republiken e Shqiperise, te ecurise se se veprimtarise se shoqerise si dhe te pervojës qe ajo do te fitoje ne te ardhmen, ortaku themelues I saj si krijues I saj ka te drejten e permiresimit te metejshem dhe te dispozitave te ketij statuti.

ORTAKU I VETEM

ELMAZ SPATA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 3464 Rep.

Nr 440 Kol.

VERTETIM

Sot me daten 31.07, 1998 (nentedhjete e tete) u paraqit, para meje noteres, personalisht ortaku I vetem, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti I identifikimit, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar I cili deklaroi se sa me siper eshte bere me vullnetin e plote e te lire te tij e firmosi rregullisht para meje noteres dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

